VENDIM
Nr. 916, datë 23.11.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 203, DATË 16.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E KULTURËS, TË PRONËS NR. 186, ME EMËRTIM 'REPARTI USHTARAK NR. 3042, QENDËR STËRVITORE', ME VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, 'PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES', TË NDRYSHUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 203, datë 16.3.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, fjalët "... për ta përdorur për ndërtimin e 'Qendrës së Artit dhe të Zejeve"' hiqen.

b) Pika 3 shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama